



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1011/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses SH.H nga Prishtina, rruga ..., kundër të paditurit H.B nga Prishtina, ..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Teuta Zhinipotoku, avokate nga Prishtina, për pagesën e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.257/17, i datës 05.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses SH.H nga Prishtina, rruga ..., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.257/17, i datës 05.12.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.257/17, i datës 05.12.2018, ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses SH.H nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri H.B nga Prishtina, që në emër të borxhit të papaguar për blerjen e banesës që gjendet në Prishtinë, ..., t`ia paguajë shumën e përgjithshme të borxhit, në vlerë prej 10.000.00 euro (dhjetëmijë), me kamatë ligjore, duke filluar nga dita e ushtrimit të kërkesëpadisë, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes-plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. II Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Kundër këtij aktgjykimi paditësja, në afat ligjor kanë paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet plotësisht e bazuar ankesa e saj, të prishet në tërësi aktgjykimi i shkallës së parë dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishgjykim.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtuar me datë 12.03.2001, në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit, ka kërkuar pagimin e borxhit në vlerën prej 10.000 Euro, për shkak se i padituri e ka privuar me dhunë nga banesa në Prishtinë, ..., duke ia hapur një xhirollogari dhe duke ia bartur mjetet në shumë prej 65.000 DM, të cilën banesë e ka shitur nën presion nga i padituri, andaj kërkon borxhin në shumë prej 10.000 €, ngase i padituri është dashur të ia paguajë shumën prej 75.000 DM sipas paditëses. Paditësja ka shtuar se nëse i padituri nuk ia paaguan shumën prej 10.000 € me kamatë ligjore, asnjëherë nuk do të lejojë përkthimin e banesës dhe se kjo është mënyra e vetme për ta nxjerrë borxhin nga i padituri, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri, përmes të autorizuarës së tij, në seancat gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, ngase e njëjta me asnjë provë nuk e vërteton kërkesëpadinë e saj, sepse i padituri e ka blerë banesën në fjalë dhe çmimin kontraktues e ka paguar në tërësi, ashtu siç janë marrë vesh dhe atë në llogarinë bankare të paditëses, i njëjti ka hyrë në posedim të banesës dhe që nga atëherë e shfrytëzon. Në fjalën përfundimtare ka potencuar se paditësja si duket ende nuk e ka të qartë se për çfarë kërkon 10.000 €, sepse paditësja thotë se i kërkoj 10.000 €, sepse ka qenë çmimi i kontraktuar për blerjen e banesës, e pastaj deklaron se kërkon shumën 10.000 €, si shumë që ka investuar paditësja për mbi kulmin, andaj i propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.257/17, i datës 05.12.2018, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, e duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja nuk ka arritur të provojë me asnjë provë shkresore se i padituri i ka mbetur borxh në shumën prej 10.000 € të kërkuar nga paditësja, në emër të borxhit të papaguar për shitblerjen e banesës në Prishtinë objekti ..., kjo për faktin se pavarësisht se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se ka ekzistuar një marrëveshje për blerjen e banesës lëndore dhe nuk është kontestuese se është paguar shuma prej 65.000 DM përmes

xhirollogarisë bankare të paditëses dhe se paditësi është shfrytëzues aktual i banesës, por megjithatë nga shkresat e lëndës nuk provohet nëse paditësja dhe i padituri janë marrë vesh që përveç shumës së paguar nga i padituri në lartësi prej 65.000 DM, të paguhet edhe vlera prej 10.000 DM për mbi kulm apo 10.000 € siç kërkon tani paditësja. Andaj gjykata ka vendosur konform nenit 319 të LPK-së dhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, ngase rezulton se paditësja me asnjë provë nuk i ka provuar pretendimet e saj, me të cilat do të konstatohej se i padituri i ka ngelur borxh paditëses në shumën e kërkuar. Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n) dhe përmban mangësi për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Pretendimet e ankuesit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse, të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor, ku gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadisë. Në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike duke e bërë administrimin e provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, nga të cilat nuk është vërtetuar fakti se pala e paditur i ka mbetur borxh paditëses në shumën e kërkuar, ku paditësja nuk ia ka ofruar gjykatës asnjë provë me të cilën do ta vërtetonte ekzistimin e borxhit, e poashtu për lartësinë e tij, ndërsa nga ana tjetër i padituri ia ka paguar paditëses çmimin e banesës në tërësi sipas kontratës, në shumë prej 65.000 DM, menjëherë përmes xhirollogarisë bankare, i njëjti ka hyrë në posedim pas pagesës së çmimit dhe aktualisht është në posedim dhe në shfrytëzimin e saj. Prandaj gjykata nuk ka mundur të bazojë vendimin e saj në supozimet e palëve, por në mungesë të provave për ti vërtetuar faktet relevante, ka

vendosur që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Në rastin konkret paditësja ka dështuar të argumentojë faktin se i padituri i ka borxh shumën prej 10.000 €, ngase me asnjë provë të vetme nuk ka argumentuar me prova se i padituri i ka ngelur borxh në shumën e lartcekur, andaj edhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pabazuar. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit në kuptim të rrethanave të provuara të kësaj çështjeje, ka vendosur duke gjetur mbështetje në nenin 319 par. 1 të LPK-së, ku ceket se “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”,

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar se nga shkresat e lëndës nuk provohet nëse paditësja dhe i padituri janë marrë vesh që përveç shumës së paguar nga i padituri në lartësi prej 65.000 DM, të paguhet edhe vlera prej 10.000 DM për mbi kulm apo 10.000 € siç kërkon tani paditësja, respektivisht rezulton se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i padituri i ka mbetur borxh paditëses në shumën prej 10.000 €, ngase paditësja në asnjë mënyrë nuk ka arritur ta provojë borxhin në lartësinë e lartcekur, ku sipas dispozitës së nenit 322 par.2 të LPK-së, parashihet se “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë ta provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”, prandaj paditësja borxhin dhe lartësinë e tij është dashur ta provojë me prova përkatëse.

Gjykata e Apelit mori për bazë edhe pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk ishin të bazuara dhe të cilat nuk ndikuan që të vendoset ndryshe se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1011/19, me datë 04.02.2021

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca Dula, d.v